

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E ARSIMIT
 SPORTIT DHE RINISË
 QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2021
 I DETYRUAR – SESIONI I

Qershor 2021

Ora 10.00

Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi GG

VARIANTI A

Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor

Udhëzime për maturantin/kandidatin

Testi përmban gjithsej 60 pikë.

Koha për zhvillimin e pyetjeve të testit është 2 orë e 30 minuta.

Testi ka 20 pyetje me zgjedhje (alternativa) dhe pyetjet e tjera janë me zhvillim.

Pikët për secilën pyetje janë dhënë përbri saj.

1. Për 20 pyetjet me zgjedhje (alternativa), pasi të keni qarkuar alternativën e saktë në test, duhet të mbushni rrathët përkatës të tabelës në fletëpërgjigje.

Lexoni me kujdes udhëzimet e dhëna në fletëpërgjigje.

2. Për pyetjet me zhvillim, përgjigjet duhet të shkruhen brenda hapësirës së dhënë.

Kërkesa	5	6	7	8	9	10a	10b	24a	24b	25	26a
Pikët											
Kërkesa	26b	27	31a	31b	32	33	34	35a	35b	35c	35d
Pikët											

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I – Gjuhë shqipe

Orientimi për të ardhmen

Para se të hidhja hapat në korridoret e gjimnazit, bashkë me disa të rinj të tjerë, ndoqëm një numër takimesh informuese, që kishin për qëllim të na orientonin për mënyrën e organizimit të kohës në shkollë. Shumë nga mësimet që na u dhanë, kanë qenë mjaft të dobishme. Planifikimi është një ide tejet e mençur. Javët e para të një semestri vendosin se si do të shkojë pjesa tjetër e vitit. Përgatitja për një test është shumë më e frytshme, nëse shtrihet në kohë, në vend që të studiohet vetëm një natë përpara provimit. Unë jam shumë mirënjohës për këto mësimet.

Megjithatë, ka edhe diçka tjetër që unë do të kisha dashur të ma kishin mësuar: sa e rëndësishme është të mos zgjedhim një fushë që e kufizon zhvillimin e individit, qoftë ai në sferën akademike apo edhe jashtë saj. Në takimet e zhvilluara, na këshilluan të përqendroheshim në studimin e një grupi lëndësh të veçanta, të cilat do të na ndihmonin të arrinim qëllimet tona finale. Megjithëse është shumë e rëndësishme t'u kushtojmë vëmendje kërkesave për diplomim, kjo vëmendje kaq e lartë krijon edhe pengesat e veta. Ajo u shkakton nxënësve aq shumë mundim për të planifikuar jetën e tyre pas përfundimit të shkollës, saqë çdo gjë në shkollë duket sikur është e mbërthyer pas saj. Ndoshta gjërat nuk janë kaq keq, por e vërteta është se nxënësit që do të ndjekin shkollën e lartë, prirjen, gjithashtu, të jenë të fiksuar pas idesë se çfarë do të bëjnë pas përfundimit të saj.

Por bota nuk mbetet gjithnjë në një vend, ajo ndryshon. Arsimimi duhet të jetë pjesë e jetës sonë edhe pas mbarimit të shkollës, si dhe duhet të jetë shumë më i gjerë nga sa e imagjinojmë. Leonardo da Vinçi shkëlqeu në një mori fushash. Si mjeshtri që krijoi “Mona Lizën”, Leonardo jo vetëm ishte piktori më i madh i të gjitha kohërave, por kontribuoi në fushën e matematikës, mjekësisë dhe inxhinierisë. Imagjinoni se çfarë do të kishte humbur bota, nëse ai do të ishte këshilluar të zgjidhte një fushë të caktuar dhe të përqendrohej vetëm në të. Da Vinçi ishte i madh, pasi ai nuk e kufizoi veten vetëm në një fushë të ngushtë studimi. Imagjinata e tij ishte e pakufi, ndaj ai nuk mund të kufizohej në një drejtim të vetëm. Unë mendoj se ata që zgjedhin të specializohen në një fushë të caktuar, nuk do të përfitonin nga ajo çfarë ekziston përtej kufijve të “fushave tona të studimit”.

Orientimi i vëmendjes së nxënësve drejt një fushe të caktuar bën që të ngushtohet vizioni i tyre. Nëse planifikojmë të shkojmë në fakultetin e shkencave, natyrshëm zgjedhim lëndët shkencore. Nëse planifikojmë të bëhemi artistë, padyshim orientohemi drejt arteve pamore. Por imagjinoni se çfarë mund të ndodhte nëse do ta ndryshonim pak vizionin tonë. Nuk ka asnjë artist, puna e të cilit nuk përmirësohet nga njohuritë shkencore dhe asnjë biolog, puna e të cilit do të dëmtohej nëse do të interesohej edhe për artin. Nxënësit e shkollës sonë duhet ta zgjerojnë horizontin e tyre dhe të bëhen pjesë e botës.

(Fragmenti është marrë nga eseja e një gjimnazisti)

Për pyetjet 1-4 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

1. Cila nga fjalitë shpreh më mirë *idenë* e tekstit? **1 pikë**
 - A) Arsimimi synon që të rinjtë të kuptojnë se bota ndryshon pambarimisht.
 - B) Përqendrimi i vëmendjes në një fushë të caktuar e kufizon zhvillimin e individit.
 - C) Të rinjtë duhet të jenë mirënjohës për takimet informuese që marrin në shkollë.
 - D) “Vizionarët” kanë qenë njerëz të rëndësishëm, për shkak të kontributeve që kanë sjellë.

2. Cila është e dhëna kryesore që përdor autori, për të mbështetur idenë e tij? **1 pikë**
 - A) Detaji rreth prirjeve të nxënësve të talentuar në shkollë.
 - B) Informacioni mbi diplomimin, si qëllimi final i nxënësve.
 - C) Fakti që studimi i një grupi lëndësh të veçanta ka ndihmuar në arritjen e qëllimit final të nxënësve.
 - D) Shembulli i arritjeve të Da Vinçit në art, shkencë dhe inxhinieri.

3. Lexoni përcaktimet e mëposhtme të marra nga Fjalori i gjuhës shqipe.

1 pikë

HORIZONT,- i

1. Vija ku duket sikur puqet qielli me tokën.
2. Hapësira sa sheh syri së largu.
3. Rrethi i dijeve.
4. Shtresë toke që mban pasuri nëntokësore, ujë etj.

Cili nga përkufizimet përputhet me përdorimin e fjalës *horizont*, të përdorur në fjalinë e fundit të tekstit të mësipërm?

- A) Përkufizimi 1
- B) Përkufizimi 2
- C) Përkufizimi 3
- D) Përkufizimi 4

4. Lexoni me kujdes fjalinë:

1 pikë

Megjithatë, ka edhe diçka tjetër që unë do të kisha dashur të ma kishin mësuar: sa e rëndësishme është të mos zgjedhim një fushë që e kufizon zhvillimin e individit, qoftë ai në sferën akademike apo edhe jashtë saj.

Ajo nënkupton se autori:

- A) beson se duhen gjykuar mësuesit, kur nxënësit nuk ia dalin të përmbushin synimet e tyre.
- B) konstaton që, për të ndjekur shkollën e lartë, ka rëndësi përqendrimi në lëndën e duhur.
- C) pohon se do të ndihej më i përgatitur për jetën, nëse shkolla do ta ndihmonte të zgjeronte formimin e tij si individ.
- D) vëren që, aktualisht, shkolla është duke i përgatitur nxënësit ashtu si duhet për të ardhmen.

5. Në *paragrafin e parë* identifikoni dy informacione të vlefshme që ka marrë autori gjatë takimeve informuese.

2 pikë

Informacioni I: _____

Informacioni II: _____

6. Pse Da Vinçi nuk e kufizoi veten në një fushë të vetme studimi?

1 pikë

7. Ç'pasojë do të kishin nxënësit, nëse do të përqendroheshin vetëm në një fushë studimi?

Cili është propozimi që bën autori për ta zgjidhur atë?

2 pikë

Pasoja: _____

Propozimi: _____

8. Lexoni fjalinë:

Ajo u shkakton nxënësve aq shumë mundim për të planifikuar jetën e tyre pas përfundimit të shkollës, saqë çdo gjë në shkollë duket sikur është e mbërthyer pas saj.

Interpretoni çfarë ka të veçantë, në aspektin *stilistikor*, zgjedhja e fjalëve nga ana e autorit, për të paraqitur idenë e tij.

2 pikë

9. Në *paragrafin e tretë* veçoni argumentin në mbështetje të tezës që mbron autori, bashkë me shembullin ilustrues.

2 pikë

Argumenti: _____

Shembulli ilustrues: _____

10.

a) Cili është qëllimi i përdorimit të thonjzave në fjalinë e mëposhtme?

1 pikë

Unë mendoj se ata që zgjedhin të specializohen në një fushë të caktuar, nuk do të përfitonin nga ajo çfarë ekziston përtej kufijve të “fushave tona të studimit”.

b) Pse autori ka zgjedhur që argumentin e tij ta mbështetë me fakte dhe me përvoja personale? Shpjegoni përgjigjen tuaj për secilin rast.

2 pikë

Me fakte: _____

Me përvoja personale: _____

Teksti i dhënë më poshtë nuk është i saktë nga ana gjuhësore. Lexojeni me kujdes!

Për pyetjet 11-20 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

Pinguinët

[1] Pinguinët u bënë aq të njohur falë ngjashmërisë komike me njeriun. [2] Ata mbajnë drejt trupin dhe duken të krekosur, mbështeten mbi këmbët lopata dhe, kur ecin, duken qesharakë dhe argëtues. [3] Shpesh i sheh të vënë në rresht si ushtarë, ecin aq të krekosur dhe krenarë, seriozë dhe të shkujdesur e shpërfillës. [4] Sa shpend i çuditshëm!

[5] Trupin e kanë të mbuluar me pendë të vogla, të dendura, skrop të zeza, të puthitur mirë njëra me tjetrën, për të mos depërtuar acari polar në trupin e dhjamur, kurse përpara kanë një brez puplash të bardha, që u jep pamjen e burrit të vogël, të veshur me frak dhe me këmbë të bardhë. [6] Në kohët parahistorike, pinguinët kanë qenë të gjatë 2m. [7] Sot njihen 17 lloje pinguinësh, më i madhi nuk e kalon gjatësinë 1m dhe peshon 36kg.

[8] Dikur pinguinët fluturonin jo më keq se shpendët e tjerë, kurse sot, nga kohët e dikurshme u kanë mbetur vetëm mbeturinat e krahëve, që nuk bëjnë për të fluturuar, por janë shumë të mirë për të notuar. [9] Çudi të duket, por njëri nga shkaqet është se pinguinët nuk kanë patur armiq. [10] Ata kanë jetuar në zona aq të largëta të Antarktidës. [11] Nuk kishte kush t'i kërcënonte. [12] Të qetë dhe të shpenguar, pinguinët e kalonin kohën sa në tokë, aq edhe në ujë. [13] Krahët zunë t'u reduktohen, t'u përshtaten si pendë notimi. [14] Këmbët iu shndërruan në lopata. [15] Në trup iu formua një shtresë dhjami, për t'u mbrojtur nga të ftohtit polar. [16] Njeriu kurdoherë i ka gjuajtur pinguinët për dhjamin e bollshëm.

11. Çfarë e dëmton kohezionin në fjalinë [2]? 1 pikë

- A) Mospërshtatja e kryefjalës me kallëzuesin.
- B) Mungesa e trajtës së shkurtër në pjesën kryesore të fjalisë.
- C) Prania e pavend e shumë mbiemrave.
- D) Pozicioni i gabuar i pjesës së nënrenditur kohore.

12. Në cilën nga fjalitë kemi përshtatje të gabuar të mbiemrit me emrin? 1 pikë

- A) Në kohët parahistorike, pinguinët kanë qenë të gjatë 2m.
- B) Nga kohët e dikurshme u kanë mbetur vetëm mbeturinat e krahëve.
- C) Njeriu kurdoherë i ka gjuajtur pinguinët për dhjamin e bollshëm.
- D) Trupin e kanë të mbuluar me pendë të vogla, të puthitur mirë njëra me tjetrën.

13. Në cilën nga alternativat *rrënja* e fjalës është *folje*? 1 pikë

- A) të bollshëm
- B) të njohur
- C) fluturonin
- D) notuar

14. Cila prej fjalive përmban më shumë mbiemra? 1 pikë

- A) Sot, nga kohët e dikurshme u kanë mbetur vetëm mbeturinat e krahëve, që nuk bëjnë për të fluturuar.
- B) Sot njihen 17 lloje pinguinësh, më i madhi nuk e kalon gjatësinë 1m dhe peshon 36kg.
- C) Shpesh i sheh të vënë në rresht si ushtarë, ecin aq të krekosur dhe krenarë, seriozë dhe të shkujdesur e shpërfillës.
- D) Të qetë dhe të shpenguar, pinguinët e kalonin kohën sa në tokë, aq edhe në ujë.

15. Ku është vendi më i përshtatshëm për ta vendosur fjalinë e mëposhtme? **1 pikë**

Pse ndodhi ky evolucion?

- A) Pas fjalisë [4]
- B) Pas fjalisë [5]
- C) Pas fjalisë [7]
- D) Pas fjalisë [8]

16. Në cilin rast fjalitë [10] dhe [11] janë lidhur në një fjali të vetme, pa e ndryshuar kuptimin e tekstit? **1 pikë**

- A) Ata kanë jetuar në zona aq të largëta të Antarktidës dhe nuk kishte kush t'i kërcënonte.
- B) Ata kanë jetuar në zona aq të largëta të Antarktidës, kurse nuk kishte kush t'i kërcënonte.
- C) Ata kanë jetuar në zona aq të largëta të Antarktidës, por nuk kishte kush t'i kërcënonte.
- D) Ata kanë jetuar në zona aq të largëta të Antarktidës, saqë nuk kishte kush t'i kërcënonte.

17. Informacioni i dhënë në *paragrafin e tretë* të tekstit do të mbështetej më mirë përmes: **1 pikë**

- A) një diagrame, që tregon përqindjen e pinguinëve në disa zona të planetit.
- B) një ilustrimi, që paraqet ngjashmëritë midis njerëzve dhe pinguinëve.
- C) një fotografie, që tregon pamjen e plotë të një pingui.
- D) një tabelë, që liston lloje të ndryshme pinguinësh.

18. Cila nga alternativat zëvendëson fjalën *reduktohen* në fjalinë [13]? **1 pikë**

- A) mblidhen
- B) shkurtohen
- C) shndërrohen
- D) transformohen

19. Për cilën nga fjalitë duhet cituar burimi i informacionit, në mënyrë që teksti të fitojë besueshmëri? **1 pikë**

- A) Në kohët parahistorike, pinguinët kanë qenë të gjatë 2m.
- B) Njeriu kurdoherë i ka gjuajtur pinguinët për dhjamin e bollshëm.
- C) Shpesh i sheh të vënë në rresht si ushtarë.
- D) Trupin e kanë të mbuluar me pendë të vogla, të dendura, skrop të zeza.

20. Cila nga alternativat do të ishte një mbyllje e përshtatshme për këtë tekst? **1 pikë**

- A) Ai vlerësohet kryesisht për bukurinë që ka, për pendët e bukura që çmohen edhe si mjete zbukurimi.
- B) Ata bëjnë një jetë të harmonishme dhe kujdesen shumë për të vegjlit e tyre.
- C) Ata kanë ardhur duke u pakësuar dhe sot është e ndaluar me konventa ndërkombëtare gjuetia e tyre.
- D) Në dimër mblidhen në tufa të mëdha për të kaluar natën; ditën secili largohet për të gjetur ushqim.

PJESA II - Letërsi

Lexoni poezinë!

Ish e diela mesnatë
 e i biri i Zonjës Madhe
 ngjitej tek e bukura
 të m'i lypë¹⁾ një pikë ujë,
 se ish etit²⁾ djegur.
 Vetëm e gjeti te vatra,
 që më plekëste gërshetin³⁾.
 Ata duheshin e s'e thoshin.
 Vajza, me buzën më gaz:
 - Ç'ke që po ikën si era?
 - Më presin në roljet⁴⁾.
 - Dy mollë të ardhura,
 qëndro se t'i ruajta.
 Me një dorë ngritur
 mbante mbi veshin e bardhë
 leshtë⁵⁾ e saj të shpleksur,
 kalli tjetërën te gjiri,
 e më hoqi mollëzët,
 më ia vu në dorët,
 në çeret e ndezur.
 Thomni ju, të dashurit,
 m'ëmbël ë' të puthurit⁶⁾

Fjalorth

1) *lypë*: kërkohë2) *etit*: etja3) *plekëste gërshetin*: thurte gërshetin4) *roljet*: lojë e moçme arbëreshe për burrat5) *leshtë*: flokët6) *m'ëmbël ë' të puthurit*: nëse është aq i ëmbël të puthurit

“Këngët e Milosaos” - De Rada

Për pyetjet 21-23 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

21. Ky fragment i përket poemës romantike, sepse:

1 pikë

- A) eksploron aspektet e jashtëzakonshme të jetës njerëzore.
- B) përqendrohet në ndjenjat e brendshme të të rinjve.
- C) përshkruan dy të rinj nga mjedise të ndryshme.
- D) trajton ngjarje dhe fakte nga realiteti.

22. Cila është *Zonja e Madhe* që përmendet në këto vargje?

1 pikë

- A) Nëna e Milosaos.
- B) Një figurë e besimit arbëresh.
- C) Një nga gratë luftëtare të krahinës.
- D) Kallogreja e varfër, nëna e Rinës.

23. Në cilën nga alternativat sintaksa vjen me rend të përmbysur?

1 pikë

- A) Ç'ke që po ikën si era?
- B) mbante mbi veshin e bardhë
- C) të m'i lypë një pikë ujë,
- D) se ish etit djegur.

24.

- a) Në këtë fragment, Milosao i kërkon Rinës ujë, për të shuar etjen. A mendoni se kjo është arsyeja e vërtetë e këtij takimi? **1 pikë**

Po
 Jo

Shpjegoni përgjigjen tuaj.

- b) Identifikoni vargun që zbulon në *mënyrë të drejtpërdrejtë* lidhjen shpirtërore të të rinjve. **1 pikë**

Vargu: _____

25. Cila është figura e stilistikës që krijohet nga mungesa e foljes në vargun e mëposhtëm?

Shpjegoni efektin që krijon te lexuesi ky lloj organizimi i vargut. **2 pikë**

Vajza, me buzën më gaz:

Figura e stilistikës: _____

Shpjegimi: _____

26.

- a) Vargu: *Ç'ke që po ikën si era?* ndërtohet mbi figurën e krahasimit.

Interpretoni imazhin e përftuar nga përdorimi i kësaj figure, parë në kontekstin e të gjithë fragmentit. **2 pikë**

Interpretimi: _____

- b) Si ndryshon veta e komunikimit në dy vargjet e fundit? Cili është raporti që krijohet mes narratorit dhe lexuesit në këtë rast? **2 pikë**

Ndryshimi: _____

Raporti: _____

27. **Komentoni** mënyrën se si është bërë portretizimi i Rinës. Në përgjigjen tuaj mund të përqendrohesh në tiparet fizike ose në tiparet e karakterit të personazhit. **2 pikë**

Lexoni fragmentin!

Eugjeni kishte ngrirë në vend nga dashuria besnike e vetëmohonjëse e këtij njeriu dhe po e sodiste duke shprehur atë adhurimin e padjallëzuar që pushton shpirtat e të rinjve me një drithërim të shenjtë.

- Do të jem i denjë për të gjitha këto, - thirri ai.

- O Eugjeni im, sa bukur tingëllojnë këto që thua! - iu përgjigj zonja Dë Nysingen dhe e puthi studentin në ballë.

- Për ty ai s'pranoi as zonjushën Tajëfer me milionat e saj, - tha xha Gorioi. - Eh! Ju donte ajo vogëlushja; dhe tani që i vdiq i vëllai, u bë aq e pasur, sa edhe Krezysi.

- Oh, ç'e përmendni atë? - thirri Rastinjaku.

- Eugjen, - i tha Delfina në vesh, - kjo është një brengë për mua sonte. Ah, unë do t'ju dua shumë! Për gjithë jetën.

- Kjo është dita më e bukur për mua qëkurse u martuat! - thirri xha Gorioi. - tani le të më bëjë zoti të vuaj sa të dojë, mjaft që të mos vuaj për shkakun tënd dhe do të them me vete: "Në shkurtin e këtij viti kam qenë një çast më i lumtur nga ç'mund të jenë gjithë njerëzit tërë jetën e tyre". - Shikomë mua, Fifinë, - i tha ai së bijës. Pastaj iu kthye Eugjenit: - Sa e bukur që është, hë? Më thoni a keni parë gra të tjera me një nur të tillë e me këtë gropëzë në faqe? S'keni parë, hë? E pra, këtë engjëllushe e kam bërë vetë. Këtë e tutje, duke qenë e lumtur me ju, do të bëhet njëmijë herë më e bukur. Tani unë jam gati të shkoj në skëterrë, o fqinji im, - vijoi ai, - po ta doni pjesën që më takon në parajsë, merreni, jua kam falur. Ejani të hamë, të hamë, - përsëriti duke mos ditur më se ç'të thoshte, - të gjitha tonat janë.

- I gjori baba!

- Ah, sikur ta dije, bija ime, - i tha ai dhe u ngrit e shkoi pranë saj, i mori kokën me të dyja duart dhe e puthi te vija që i ndante flokët, - sa të lumtur do të më bëje me diçka që s'të kushton asgjë! Eja më shiko ngandonjëherë, unë do të jem këtu lart, vetëm një hap do të bësh. Premtomë që do të vish, thuamë....

- E shikoni, - i tha Delfina Eugjenit, - kur është me ne im atë, duhet të jesh e tëra e tij. Do të na bezdisë ngandonjëherë.

"Xha Gorioi" - Balzak

Për pyetjet 28-30 qarkoni alternativën që ju mendoni si të saktë. Më pas plotësoni përgjigjen edhe në fletën e përgjigjeve.

28. Në fjalinë: *Eugjen, - i tha Delfina në vesh, - kjo është një brengë për mua sonte,* fjala **brengë** ka kuptimin:

1 pikë

- A) bezdi
- B) harrim
- C) mërzi
- D) trishtim

29. Në cilën nga alternativat e mëposhtme është përdorur pasthirrma?

1 pikë

- A) Për gjithë jetën.
- B) Do të na bezdisë ngandonjëherë.
- C) Oh, ç'e përmendni atë? - thirri Rastinjaku.
- D) Premtomë që do të vish, thuamë....

30. Në cilën nga fjalitë xha Gorioi i lutet me përgjërim së bijës?

1 pikë

- A) ... tani le të më bëjë zoti të vuaj sa të dojë.
- B) Premtomë që do të vish, thuamë....
- C) ... po ta doni pjesën që më takon në parajsë, merreni, jua kam falur.
- D) Ejani të hamë, të hamë, - përsëriti duke mos ditur më se ç'të thoshte, - të gjitha tonat janë.

31.

a) Cila është gjendja shpirtërore e xha Gorioit në fragment? Çfarë e ka shkaktuar atë?

2 pikë

Gjendja shpirtërore: _____

Arsyeja: _____

b) Çfarë vlerëson xha Gorioi te vajza e tij? Mbështeteni idenë tuaj me detaje nga fragmenti.

2 pikë

Detajet: _____

32. Cila është ndjesia që provon Eugjeni për xha Gorioin? Identifikojeni atë, bashkë me një shembull ilustrues.

1 pikë

Ndjesia: _____ Shembulli: _____

33. Zbuloni çiftin e fjalëve që krijon *kundërvënien* në fjalinë e mëposhtme.

3 pikë

Tani unë jam gati të shkoj në skëterrë, o fqinji im, - vijoi ai, - po ta doni pjesën që më takon në parajsë, merreni, jua kam falur.

Nisur nga i gjithë fragmenti, interpretojini këtë kundërvënie, duke e lidhur me thelbin e figurës së xha Gorioit.

Çifti i fjalëve: _____

Interpretimi: _____

34. Bazuar në **dy paragrafët** e fundit të fragmentit, zbuloni një cilësi të karakterit të Delfinës.

Pse mendoni se kjo është cilësia që e karakterizon atë? Jepni një detaj apo shprehje që mbështet përgjigjen tuaj.

2 pikë

Cilësia: _____

Shpjegimi: _____

Shënim:

Kjo fletë mund të përdoret nga ana juaj për planifikimin e përgjigjeve.

Shënimet e hedhura këtu nuk do të merren parasysh nga ana e vlerësuesve.

QSHA 2021